




Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center



GJENDJA EKONOMIKE E GRAVE ROME, ASHKALIKE DHE EGJIPTIANE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME
MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA
RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Financuar nga:

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) ëëë.kgscenter.net QKSGJ-ja ka kontribuar në integrimin thelbësor gjinor prej vitit 2002 dhe përpiqet vazhdimisht të arrijë barazinë gjinore në Kosovë. Ka qenë nismëtare për arritjen e ndryshimeve në sistemin diskriminues, normave shoqërore dhe standardeve të dyfishta dhe është shumë aktive në monitorimin e institucioneve publike. Misioni i QKSGJ-së është integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha analizat, programet dhe politikat e të gjithë sektorëve të shoqërisë kosovare, përmes ngritjes së vetëdijes dhe përqendrimit në çështje gjinore, zhvillimit të studimeve gjinore dhe duke siguruar përfshirjen e politikave të ndjeshme nga aspekti gjinor përmes hulumtimeve, zhvillimit të politikave, avokimit dhe lobimit.

Ky hulumtim është kryer nga QKSGJ përmes IDRA Resarch and Consulting në kuadër të projektit “Adresimi i nevojave të nënave vetëushqyese dhe grave rome, ashkallike dhe egjiptase në ekonomi” të financuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në Kosovë (ABGj -Zyra e Kryeministrit, në kuadër të mbështetjes financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi – “Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021 -Masa 4 e fazës së dytë”.

Përgjegjësia Ky raport hulumtues është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e raportit është përgjegjësi e vetme e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e ABGj.

Autorësia ©Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet ose të futet në një sistem kërkimi ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose ndryshe, pa lejen paraprake të QKSGJ-së

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	7
Metodologjia e anketës.....	7
Profili i të anketuarave	9
Arsimi, informimi dhe punësimi	11
Mirëqenia ekonomike, sociale dhe shëndetësore.....	19
Përfundime dhe rekomandime	30
Referenca.....	33

LISTA E FIGURAVE

Figura 1	Gratë e anketuara, sipas shtrirjes rajonale	9
Figura 2	Gratë e anketuara, sipas grupmohës	9
Figura 3	Gratë e anketuara, sipas përkatësisë etnike.....	9
Figura 4	Gratë e anketuara, sipas llojit të vendbanimit.....	9
Figura 5	Gratë e anketuara, sipas nivelit të shkollimit.....	10
Figura 6	Gratë e anketuara, sipas statusit civil	10
Figura 7	Numri i anëtarëve të familjes.....	10
Figura 8	Numri i anëtarëve të familjes mbi 14 vjeç	10
Figura 9	Situata aktuale e banimit.....	10
Figura 10	Përbërja e anëtarëve me të cilët jetojnë	10
Figura 11	Arsyet e lënies së shkollës fillore dhe të mesme	11
Figura 11b	Arsyet e lënies së shkollës fillore dhe të mesme, sipas grupmohës.....	12
Figura 12	Kanalet më të përdorura të informimit	12
Figura 13	Kanalet më të përdorura të informimit për politikë, ekonomi, çështje të tjera aktuale, sipas grupmohës	13
Figura 14	Kanalet më të përdorura të informimit për politikë, ekonomi, çështje të tjera aktuale, sipas nivelit të shkollimit	13
Figura 14	Kanalet më të përdorura të informimit për politikë, ekonomi, çështje të tjera aktuale, sipas statusit të punësimit.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 15	Posedimi i kontratës për të anketuarat e punësuar	14
Figura 16	Orari i punës për të anketuarat e punësuar	14
Figura 17	Mënyra e marrjes së pagës për të anketuarat e punësuar	14
Figura 18	Mosha kur kanë filluar punën të anketuarat e punësuar	14
Figura 19	Sfidat në punësim të të gjitha grave të anketuara, sipas grupmohës	15
Figura 20	Sfidat në punësim të të gjitha grave të anketuara, sipas përkatësisë etnike.....	16
Figura 21	Arsyeja pse nuk punojnë gratë që nuk janë duke punuar dhe nuk kërkojnë punë, sipas grupmohës	16
Figura 22	Arsyeja pse nuk punojnë gratë që nuk janë duke punuar dhe nuk kërkojnë punë, sipas përkatësisë etnike.....	17
Figura 23	Dëshira për të punuar e grave që nuk janë duke punuar dhe kërkojnë punë dhe atyre që nuk kërkojnë punë, sipas grupmohës.....	17
Figura 24	Spektori i preferuar i punës i grave të papunësuar që do të dëshironin të punonin	17
Figura 25	Aplikimi për punë i grave të papunësuar, sipas grupmohës.....	18
Figura 26	Aplikimi për punë i grave të papunësuar, sipas përkatësisë etnike	18
Figura 27	Regjistrimi në entin për punësim	18
Figura 28	Dija për programe të aftësimi profesional në komunitetin e tyre	19
Figura 29	Pjesëmarrja në ndonjë trajnim e grave të anketuara.....	19
Figura 30	Pjesëmarrja e vajzave/grave në trajnime ku të anketuarat kanë marrë pjesë	19
Figura 31	Gjendja ekonomike e familjeve të grave të anketuara.....	20
Figura 32	Brenga për mirëqenien e tyre, sipas nivelit të të ardhurave.....	20
Figura 33	Brenga për mirëqenien e tyre, sipas rajonit	21
Figura 34	Angazhim urgjent institucional për çështje të ndryshme.....	21
Figura 35	Përkeqësimi i gjendjes ekonomike pas përhapjes së COVID-19	22
Figura 36	Kanalet e informimit rreth COVID-19, sipas grupmohës	22
Figura 37	Kanalet e informimit rreth COVID-19, sipas statusit të punësimit	23
Figura 38	Ndjesia e rritjes së paragjykimeve apo diskriminimit etnik që nga përhapja e COVID-19, sipas grupmohës	23
Figura 39	Ndjesia e rritjes së paragjykimeve apo diskriminimit etnik që nga përhapja e COVID-19, sipas rajonit.....	23

Figura 40 Ndjesia e rritjes së paragjyqimeve apo diskriminimit etnik që nga përhapja e COVID-19, sipas përkatësia etnike	24
Figura 41 Përshtypja mbi rritjen e dhunës në familje pas përhapjes COVID-19, sipas grupmoshës.....	24
Figura 42 Përshtypja mbi rritjen e dhunës në familje pas përhapjes COVID-19, sipas rajonit	24
Figura 43 Qasja në shërbime të shëndetit riprodhues pas përhapjes së COVID-19	25
Figura 44 Punësimi para COVID-19 i grave të papunësuar ose me punësim jo-stabil.....	25
Figura 45 Arsyet për humbjen e punës pas përhapjes së COVID-19.....	25
Figura 46 Mirëqenia ekonomike pas përhapjes së COVID-19, sipas grupmoshës	26
Figura 47 Mirëqenia ekonomike pas përhapjes së COVID-19, sipas rajonit	26
Figura 48 Mirëqenia ekonomike pas përhapjes së COVID-19, sipas përkatësisë etnike	26
Figura 49 Ndhima të pranuar që nga përhapja e COVID-19	27
Figura 50 Ndhimat e pranuar që nga përhapja e COVID-19, sipas dhuruesve.....	27
Figura 51 Niveli i pajtimit me pohime të ndryshme rreth dinamikës gjinore në familje	28
Figura 52 Niveli i pajtimit me pohime të ndryshme rreth dinamikës gjinore në familje, sipas grupmoshës	29
Figura 53 Niveli i pajtimit me pohime të ndryshme rreth dinamikës gjinore në familje, sipas nivelit të shkollimit.....	29
Figura 54 Niveli i pajtimit me pohime të ndryshme rreth dinamikës gjinore në familje, sipas përkatësisë etnike	30

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Mostra e synuar sipas gjinisë.....	8
Tabela 2 Mostra e synuar sipas grupmoshës.....	8
Tabela 3 Mostra e synuar sipas rajonit	8
Tabela 4 Mostra e synuar sipas llojit të vendbanimit	8

HYRJE

Gratë rome, ashkallike dhe egjiptiane janë ndër kategoritë më të paprivileguara shoqërore, gjendja e së cilave kushtëzohet nga racizmi dhe seksizmi ekzistent në Kosovë. Ato janë në pozita dukshëm më të ndjeshme në krahasim me gratë e komunitetit shumicë dhe në krahasim me burrat e vetë komuniteteve etnike. Për shkak të praktikave raciste dhe seksiste në të gjitha sferat e organizimit të jetës publike dhe private, gratë nga këto komunitete hasin barriera të theksuara në angazhim dhe pjesëmarrje në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike.

Pjesëmarrja ekonomike e grave rome, ashkallike dhe egjiptiane mbetet një nga sfidat kryesore të cilat i pengojnë ato në afirmimin e subjektivitetit dhe pozitës së tyre në hapësirat private dhe ato publike. Kjo për shkak që këto gra kanë dukshëm më pak mundësi për t'u arsimuar, punësuar dhe për t'u angazhuar në aktivitete jashtë hapësirave shtëpiake.

Elementet kryesore që merren parasysh në fuqizimin ekonomik të grave janë qasja e tyre në arsim, punësim, në trashëgimi nga familjet e tyre si dhe në marrjen e vendimeve personale dhe familjare për të matur shkallën e fuqizimit të tyre. Nëse konsiderojmë shkallën e punësimit dhe të papunësisë për vitin 2020, vetëm 14.1% e grave janë të punësuar, e papunësia e grave është 32.3%. Për më tepër, përveç punësimit të ulët e papunësisë së madhe, gratë janë grupi më jo-aktiv për sa i përket moskërkimit të punës (79.2%). Edhe pse të dhënat e hapura nga Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk shfaqin të dhënat e punësimit sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptiane është edhe më e rëndë.

Korniza ligjore e Kosovës përbëhet nga një numër ligjesh që synojnë garantimin e të drejtave të barabarta për komunitetet pakicë dhe të promovimit të mundësive të tyre për të arritur përfaqësim të denjë, mirëqenie si dhe gjendje ekonomike të volitshme. Konkretisht, kjo bëhet përmes mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Kosovë, përmes sigurimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare, përmes sigurimit të qasjes në arsim, dhe respektimit të trashëgimisë kulturore të çdo komuniteti.

Për të vlerësuar gjendjen ekonomike të grave rome, ashkallike dhe egjiptiane në Kosovë, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) e mbështetur nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) -Zyra e Kryeministrit kanë zhvilluar një pyetësor për të vlerësuar mendimet dhe përjetimet e grave rome, ashkallike dhe egjiptiane në lidhje me gjendjen e tyre sociale dhe ekonomike e cila është zbatuar nga IDRA Research and Consulting.

Ky raport përfshin metodologjinë e hulumtimit si dhe rezultatet e anketës mbi gjendjen ekonomike të grave rome, ashkallike dhe egjiptiane.

METODOLOGJIA E ANKETËS

Me qëllim të vlerësimit të gjendjes ekonomike të grave rome, ashkallike dhe egjiptiane është kryer një anketë me 250 gra rome, ashkallike dhe egjiptiane në Kosovë për të mbledhur opinionet, perceptimet dhe përvojat e tyre në raporte shoqërore dhe sidomos në punësim. Të dhënat u mbledhën përmes anketave ballë-për-ballë duke shfrytëzuar tabletat dhe u realizuan nga 30 shtatori deri më 8 tetor 2021.

Për këtë studim u përdor metodologjia e mostrës proporcionale dhe përzgjedhjes së rastit për të intervistuar gra të komuniteteve të lartpërmendura. Ekzistojnë dy lloje të mostrave me kuota: proporcionale dhe jo proporcionale. Për këtë studim, kemi marrë mostër proporcionale e cila është një metodë që përcakton karakteristikat kryesore të popullsisë në fjalë duke marrë një sasi proporcionale sipas secilës kategori, p.sh. rajonit, komunës, moshës, apo edhe gjinisë (edhe pse në këtë rast kemi

pasur vetëm gra). Madhësia e mostrës së këtij studimi jep mundësinë e analizës së gjetjeve jo vetëm në nivel të përgjithshëm, por gjithashtu edhe sipas kategorive kryesore demografike. Veç kësaj, u tregua kujdes që parametri i rajonit të jetë sa më përfaqësues për studimin në fjalë. Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave zyrtare mbi shpërndarjen e popullsisë të komuniteteve në fokus sipas rajoneve të Kosovës, u zbatuan kuotat për rajonet. Parametrat e tjerë të mostrës siç është moshë apo lloji i vendbanimit, janë përfaqësues duke respektuar shpërndarjen e popullsisë së Kosovës si e tërë. Në rastet kur zbatohet metodologjia e mostrës me kuota bëhet zgjedhja e njerëzve në mënyrë rastësore por gjithnjë duke respektuar një kuota apo numër të caktuar intervistash. Kjo metodë përdoret për të siguruar që grupet më të vogla të jenë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në mostrën tonë.

Fillimisht, sipas statistikave zyrtare janë identifikuar komunat në Kosovë ku ka më shumë popullsi rome, ashkallike dhe egjiptiane që kanë rezultuar se janë komuna të gjashtë rajoneve administrative në Kosovë. Pastaj, për pjesën tjetër të karakteristikave demografike iu kemi referuar të dhënave demografike të përgjithshme. Si rrjedhojë, intervistat janë shpërndarë si më poshtë:

Tabela 1 Mostra e synuar sipas gjinisë

Gjinia	Përqindja	# i anketave
Gra	100%	250
Total	100%	250

Tabela 2 Mostra e synuar sipas grupmoshës

Grupmosha	Përqindja	# i anketave
18-24	20%	50
25-34	25%	63
35-44	15%	38
45-54	15%	38
55-64	15%	38
65+	10%	25
Total	100%	250

Tabela 3 Mostra e synuar sipas rajonit

Rajoni	Përqindja	# i anketave
Gjakovë	18%	45
Prishtinë	30%	75
Prizren	13%	33
Pejë	11%	28
Mitrovicë	11%	27
Ferizaj	28%	70
Total	100%	7250

Tabela 4 Mostra e synuar sipas llojit të vendbanimit

Lloji i vendbanimit	Përqindja	# i anketave
Rural	60%	150
Urban	40%	100
Total	100%	250

Duke qenë se hulumtimi është përqendruar vetëm në përvojat dhe opinionet e grave rome, ashklike dhe egjiptiane, anketueseve ju ndanë lokacione brenda komunave që kanë dendësi më të madhe të romëve, ashklike dhe egjiptianëve dhe u intervistua një grua për shtëpi në mënyrë që të mund të arrijnë kuotat e caktuara. Në rastet kur kishte përqendrim të një numri të konsiderueshëm të familjeve të këtyre komuniteteve, u zbatua metoda e trokitjes një-në-tre dyer për të bërë të mundur përfaqësimin sa më të plotë e të rastit. IDRA aplikon gjithashtu teknika të kontrollit të cilësisë së intervistave të mbledhura duke bërë mbikëqyrje në terren apo telefonata për qëllime verifikimi.

PROFILI I TË ANKETUARAVE

Pjesa e parë e këtij raporti tregon karakteristikat demografike të grave të anketuara. Siç është diskutuar në pjesën e metodologjisë të këtij raporti, të anketuarat e kësaj ankete janë nga gjashtë rajone të Kosovës. Saktësisht, rreth 28% e tyre jetojnë në rajonin e Prishtinës, 20% në rajonin e Ferizajt, 18% në rajonin e Gjakovës, 13% në rajonin e Prizrenit, 11% në rajonin e Pejës dhe 10% në rajonin e Mitrovicës.

Ndërsa, sa i përket moshës, 32% e grave të anketuara janë 18-30 vjeç, 36% janë 31-44 vjeç dhe 33% janë mbi 44 vjeç.

Figura 1 Gratë e anketuara, sipas shtrirjes rajonale





Figura 2 Gratë e anketuara, sipas grupmoshës



Sa i përket përkatësisë etnike, 63% e grave të anketuara janë ashklike, 23% janë egjiptiane dhe 14% janë rome. Po ashtu, gjysma e grave që jetojnë në qytete jetojnë në të njëjtin vend që prej lindjes dhe gjysma nuk jetojnë aty që prej lindjes. Ndërsa, 30% e grave e anketuara që jetojnë në fshatra jetojnë në të njëjtin vend që prej lindjes e 70% e tyre nuk jetojnë aty që prej lindjes.

Figura 3 Gratë e anketuara, sipas përkatësisë etnike





Figura 4 Gratë e anketuara, sipas llojit të vendbanimit



Sa i përket shkollimit, mbi gjysma e të anketuarave kanë shkollë fillore të përfunduar apo të papërfunduar, 33% janë pa shkollë dhe 13% kanë kryer shkollën e mesme apo më shumë. Ndërsa, 79% e të anketuarave janë të martuara dhe 21% janë beqare, të divorcuara, apo të veja.

Figura 5 Gratë e anketuara, sipas nivelit të shkollimit





Figura 6 Gratë e anketuara, sipas statusit civil



Familjet e 28% të të anketuarave kanë 5-6 anëtarë, e 33% të të anketuarave kanë 1-4 anëtarë dhe e 28% të tyre kanë më shumë se gjashtë anëtarë. Kurse, sa i përket anëtarëve të familjes mbi 14 vjeç, 42% kanë 3-4 anëtarë mbi këtë moshë, 30% kanë 0-2 anëtarë mbi këtë moshë dhe 28% kanë më shumë se katër anëtarë mbi këtë moshë.

Figura 7 Numri i anëtarëve të familjes





Figura 8 Numri i anëtarëve të familjes mbi 14 vjeç



Të anketuarat pastaj u pyetën se ku dhe me kë banojnë aktualisht. K, 91% e tyre jetojnë në një shtëpi apo apartament, 6% jetojnë në një shtëpi apo apartament me qira dhe 3% jetojnë në një strehim të përkohshëm. Ndërsa sa i përket se me kë jetojnë, 70% jetojnë me familjen e ngushtë, 23% jetojnë në bashkësi, 4% jetojnë me partnerin/të dashurin, 2% jetojnë vetëm dhe 1% jetojnë me shoqe/shokë.

Figura 9 Situata aktuale e banimit





Figura 10 Përbërja e anëtarëve me të cilët jetojnë




ARSIMI, INFORMIMI DHE PUNËSIMI

Pjesa e dytë e raportit shpalosë rezultatet e anketës të ndërlidhura me statusin e arsimit dhe punësimin si dhe burimet e informimit tek këto gra. Një theks i veçantë në këtë pjesë i është dhënë sfidave të cilat gratë nga këto komunitete i hasin e të cilat i përcaktojnë edhe vendimet që ato i ndërmarrin në raport me shkollimin, krijimin e familjeve dhe punësimin.


Niveli i shkollimit të ulët tek gratë rome, ashkallike dhe egjiptiane mbetet shqetësues. Një përqindje e lartë e të anketuarave, prej 33% kanë raportuar që janë pa shkollë. Kjo përqindje bie nga niveli në nivel, me vetëm 4% të grave nga komunitete të cilat kanë përfunduar studime universitare. Arsytet për mos-shkollim apo shkollim të lënë në gjysmë, tregojnë që fenomeni i mos-shkollimit ose/dhe braktisjes së shkollës lidhet ngushtë me kushtet ekonomike dhe normat shoqërore, të cilat ua përcaktojnë edhe vetë vendimet grave. Më shumë prej grave të anketuara që kishin lënë shkollën fillore të papërfunduar e kishin bërë është për shkak të kushteve ekonomike (38%). Disa nga to pastaj përmendën familjen (18%) si arsye, kohën e rrezikshme për shkollim (17%), se nuk kanë pasur dëshirë ta vazhdojnë (11%), se janë martuar (10%), dhe angazhimet familjare (4%). Kurse më pak gra që kishin vijuar shkollën e mesme e kishin lënë të papërfunduar, e dy prej tyre thonë se nuk kanë pasur dëshirë ta vazhdojnë tutje, ndërsa një nga to thotë se e ka lënë për shkak të martesës.

Figura 11 Arsyet e lënies së shkollës fillore dhe të mesme



Nëse i analizojmë arsyet e lënies së shkollës fillore sipas grupmoshës, mund të vërejmë se për më shumë gra të grupmoshës 18-30 vjeç arsyeja kryesore ka qenë fakti që thjeshtë nuk kanë pasur dëshirë ta vazhdojnë (33%), për ato 31-44 vjeç dhe mbi 44 vjeç kanë qenë kushtet ekonomike (50% dhe 35%, përkatësisht).

Figura 12 Arsyet e lënies së shkollës fillore dhe të mesme, sipas grupmoshës




INFORMIMI

Kjo pjesë shpalosë të gjeturat të cilat kanë pasur për qëllim identifikimin e kanaleve informuese për gratë rome, ashkalike dhe egjiptiane. Duke qenë se sot si asnjëherë më parë, tregu i punëkërkesve është teknologjizuar, është e nevojshme të dihet se sa janë të qasshme thirrjet e hapura për punësim për këto gra, duke e evidentuar nivelin e përdorimit të mjeteve teknologjike nga to. Në anën tjetër, është fundamentale të dihet sa janë të qasshme mjetet e komunikimit dhe informimit për gratë nga këto komunitete, për ta vlerësuar kështu edhe nivelin e mirëqenies së tyre.


Pavarësisht llojit të informacionit të marrë, shumica e të anketuarave përdorin televizionin për t'u informuar për politikë, ekonomi, çështje të tjera aktuale (87%), sport, art dhe kulturë (85%) si dhe për interesime të tjera (80%). Të dytat me radhë vijnë rrjetet sociale (35%, 36% dhe 39% për secilin lloj informacioni përkatësisht). Dhe e treta me radhë përmendet interneti në përgjithësi, pra përtej rrjeteve sociale (16%, 15%, 19% për secilin lloj informacioni përkatësisht). Mënyrat tjera të informimit përmenden më pak. Kurse, një përqind thonë se nuk përdorin fare asnjë kanal informimi për politikë, ekonomi dhe çështje tjera aktuale.

Figura 13 Kanalet më të përdorura të informimit




Analizuar nga këndvështrimi i moshës, më shumë të anketuara mbi 44 vjeç përdorin televizionin (94%), pastaj ato 31-44 vjeç (93%) dhe në fund ato 18-30 vjeç (73%) për informim rreth politikës, ekonomisë dhe çështjeve aktuale. Kurse e kundërta ndodh për përdorimin e rrjeteve sociale, pra, më tepër të anketuara 18-30 vjeç (58%) përdorin rrjetet sociale, pastaj ato 31-44 vjeç (29%) dhe në fund ato mbi 44 vjeç (18%).

Figura 14 Kanalet më të përdorura të informimit për politikë, ekonomi, çështje të tjera aktuale, sipas grupmoshës



Kurse analizuar nga këndvështrimi i nivelit të shkollimit, më shumë gra pa shkollë (92%) apo me shkollë fillore të filluar e të përfunduar (90%) sesa ato gra që kanë shkollë të mesme apo më lart (63%) përdorin televizionin për t'u informuar për politikë, ekonomi dhe çështje aktuale. Nga ana tjetër, më shumë gra me shkollë të mesme apo më lart (84%) përdorin rrjetet sociale, pastaj ato që kanë filluar apo përfunduar shkollën fillore (36%) dhe ato që nuk kanë shkollë fare (14%).


Figura 15 Kanalet më të përdorura të informimit për politikë, ekonomi, çështje të tjera aktuale, sipas nivelit të shkollimit



PUNËSIMI TEK GRATË ROME, ASHKALIKE DHE EGJIPTIANE

Niveli i punësimit të grave rome, ashkallike dhe egjiptiane mbetet nën nivelin e përgjithshëm të grave në Kosovë të cilat punojnë. Vetëm 8% e grave të anketuara janë të punësuar (qoftë edhe të vetëpunësuar apo pjesërisht të punësuar), ndërsa pjesa tjetër janë të papunësuar (më shumë janë amvise, apo nuk kërkojnë punë dhe më pak studente apo pensioniste). Prej atyre që janë të punësuar, vetëm 12 (apo 57%) kanë kontratë të rregullt pune, 6 (apo 29%) nuk kanë kontratë të rregullt pune dhe 3 (14%) janë të vetë punësuar.

Figura 16 Posedimi i kontratës për të anketuarat e punësuar



Sa i përket orarit të punës, 17 (apo 81%) punojnë me orar të plotë dhe 4 (apo 19%) punojnë me orar të shkurtuar. Dy të tretat prej tyre (13 gra, apo 62%) paguhen përmes bankës, rreth pesë (24%) paguhen kesh.

Figura 17 Orari i punës për të anketuarat e punësuar






Figura 18 Mënyra e marrjes së pagës për të anketuarat e punësuar



Për më tepër, gratë e punësuar po ashtu janë pyetur se në cilën moshë kanë filluar punën dhe 7 (apo 33%) e tyre kanë filluar në moshën 18-21 vjeç, tetë (apo 38%) e tyre kanë filluar punën në moshën 22-29 vjeç dhe gjashtë (apo 29%) e tyre kanë filluar punën në moshë më të vjetër - 30-50 vjeç.


Figura 19 Mosha kur kanë filluar punën të anketuarat e punësuar



Të gjitha gratë e anketuara janë pyetur me sfidat kryesore që janë ballafaquar rreth punësimit të tyre potencial. Një pjesë më e madhe e të anketuarave (35%) janë shprehur se kanë pasur vështirësi të përmbushin kriteret e kërkuara për vendin e punës, përcjellë nga gjetja e një pune që i përshtat


kualifikimeve të tyre (18%). Më pak gra nuk kanë arritur të kalojnë procesin e rekrutimit (9%), nuk kanë pasur mbështetje nga bashkëshorti (8%), kanë pasur mungesë të mbështetjes nga familja e gjerë (7%) apo e ngushtë (3%). Pjesa tjetër shprehen se kanë qenë keq me shëndet, s'kanë pasur nevojë të punësohen, apo edhe kujdesi për fëmijët. Nëse analizojmë të dhënat sipas moshës, vërejmë se më shumë gra të reja, pra 18-30 vjeç (25%) kanë hasur në vështirësi të gjejnë punë që i përshtatet kualifikimeve të tyre krahasuar me ato 31-44 vjeç dhe mbi 44 vjeç (nga 15% përkatësisht). Pak më shumë gra të njëjtës grupmoshë, pra 18-30 vjeç shprehen se nuk kanë pasur përkrahjen e familjes (11%) sesa të grupmoshave tjera (nga 9% përkatësisht).

Figura 20 Sfidat në punësim të të gjitha grave të anketuara, sipas grupmoshës



Nëse analizojmë të dhënat sipas përkatësisë etnike, mjaft më shumë gra rome (29%) nuk kishin pasur përkrahje nga bashkëshorti për punësim sesa egjiptiane (9%) dhe ashkallike (3%). Kurse, gratë e anketuara egjiptiane kanë qenë më pak të përkrahura nga familja e ngushtë dhe e gjerë (17%) se sa gratë ashkallike (9%) dhe rome (6%).


Figura 21 Sfidat në punësim të të gjitha grave të anketuara, sipas përkatësisë etnike



Gratë që nuk janë duke punuar dhe nuk kërkojnë punë, u pyetën se cila është arsyeja pse nuk punojnë. Në përgjithësi, më së shumti nga këto të anketuara deklaruan se nuk punojnë e nuk kërkojnë punë për shkak të obligimeve familjare (48%), pastaj se nuk plotësojnë kriteret për punë (18%). Më pak nga to deklarojnë se nuk punojnë për shkak të moshës (8%), gjendjes shëndetësore (7%), apo se ballafaqohen me diskriminim etnik (7%). Po ashtu, një pjesë më e vogël e të anketuarave thonë se nuk e shohin të nevojshme të punojnë (5%) apo thonë se shkaktojnë për mos kërkimin e punës është tregu i punës (3%).


Pothuajse një e treta e të anketuarave 18-30 vjeç (58%) deklarojnë se arsyeja pse nuk punojnë janë obligimet familjare. Megjithatë vetëm një pjesë e grave të anketuara të kësaj grupmoshe deklarojnë mos përkrahjen familjare (13%) si arsye për të mos punuar, ndërsa grupmoshat e tjera jo. Rreth dy të tretat e grave të anketuara të grupmoshës 31-44 vjeç (61%) deklarojnë se arsyeja që nuk punojnë janë obligimet familjare. Më shumë se një e treta e grave mbi 44 vjeç (37%) dhe rreth një e katërta e tyre (26%) deklarojnë se gjendja shëndetësore dhe moshja janë arsyet pse nuk punojnë.

Figura 22 Arsyeja pse nuk punojnë gratë që nuk janë duke punuar dhe nuk kërkojnë punë, sipas grupmoshës



Nëse i analizojmë arsyet pse nuk punojnë dhe nuk kërkojnë punë disa nga gratë e anketuara sipas përkatësisë etnike, vërejmë se më shumë gra rome (14%) dhe egjiptiane (13%), e më pak ashklike (4%) përmendin diskriminim etnik si arsye. Ndërsa, vetëm një pjesë e grave të anketuara ashklike (9%) përmendin mos plotësimin e kriterëve si arsye e gratë e anketuara rome e egjiptiane s'e përmendin fare. Megjithatë këto të dhëna duhet të trajtohen si indikative dhe jo përfaqësuese, meqë në këtë grup hynë shumë pak anketa të realizuara me gra rome dhe egjiptiane.

Figura 16 Arsyeja pse nuk punojnë gratë që nuk janë duke punuar dhe nuk kërkojnë punë, sipas përkatësisë etnike



Të anketuarat që janë papunësuar dhe kërkojnë apo nuk kërkojnë punë, pastaj u pyetën nëse kanë dëshirë të punojnë. Shumica e tyre (78%) kanë deklaruar se dëshirojnë të punojnë, e vetëm 22% që jo. Sa më të reja të anketuarat, aq më shumë dëshirojnë të punojnë. Pra, më shumë gra të grupmoshës 18-30 vjeç (84%), pastaj të moshës 31-44 vjeç (77%) dhe në fund të moshës mbi 44 vjeç (70%) dëshirojnë të punojnë.

Nga gratë e papunësuar që dëshirojnë të punojnë, 75% e tyre dëshirojnë të punojnë në sektorin privat, 21% në sektorin publik dhe 4% në organizata të shoqërisë civile.

Figura 24 Dëshira për të punuar e grave që nuk janë duke punuar dhe kërkojnë punë dhe atyre që nuk kërkojnë punë, sipas grupmoshës





Figura 25 Sektori i preferuar i punës i grave të papunësuar që do të dëshironin të punonin



Po ashtu të anketuarat e papunësuar u pyetën nëse ndonjëherë kanë aplikuar për punë. Dy të tretat e tyre (66%) nuk kanë aplikuar asnjëherë, rreth 29% kanë aplikuar, por nuk janë pranuar, ndërsa 4% kanë hezitur të aplikojnë. Më shumë gra të grupmoshës 31-44 vjeç (74%), pastaj ato mbi 44 vjeç (67%) dhe më pak nga 18-30 vjeç (59%), nuk kanë aplikuar asnjëherë për punë.

Më shumë gra rome (33%) sesa ashklike (31%) dhe egjiptiane (18%) deklarojnë se kanë aplikuar për punë por nuk janë pranuar. Ndërsa më shumë gra egjiptiane (77%) se rome (67%) dhe ashklike (64%) nuk kanë aplikuar asnjëherë për punë.

Figura 26 Aplikimi për punë i grave të papunësuar, sipas grupmoshës






Figura 27 Aplikimi për punë i grave të papunësuar, sipas përkatësisë etnike




Ndërsa në përgjithësi të anketuarat u pyetën nëse janë të regjistruara në entin për punësim, ku 45% e tyre deklaruan se janë e 55% se nuk janë të regjistruara në entin për punësim.

Figura 28 Regjistrimi në entin për punësim



Lidhur me rritjen e mundësive për punësim të anketuarat u pyetën nëse ekziston ndonjë program për aftësimin profesional në komunitetin e tyre. Rreth 55% e tyre thonë se nuk ekzistojnë programe për qëllim për aftësimin profesional, 30% thonë se ekzistojnë programe për aftësimin profesional dhe 14% nuk e dinë nëse ekzistojnë programe për aftësimin profesional në komunitetin e tyre.

Figura 17 Dija për programe të aftësimin profesional në komunitetin e tyre



Për më tepër, të gjitha të anketuarat u pyetën nëse kanë përfunduar ndonjë trajnim, dhe 29% e tyre thanë se kanë përfunduar trajnime profesionale, ndërsa 71% jo. Pastaj kur u pyetën se a marrin pjesë gra dhe vajza të tjera në trajnimet që vijnë, 46% thanë po, ndërsa 24% thanë jo.

Figura 30 Pjesëmarrja në ndonjë trajnim e grave të anketuara






Figura 18 Pjesëmarrja e vajzave/grave në trajnime ku të anketuarat kanë marrë pjesë



MIRËQENIA EKONOMIKE, SOCIALE DHE SHËNDETËSORE


Sa i përket gjendjes ekonomike familjare, nga 25% e grave mendojnë se të ardhurat e familjes janë të mjaftueshme për të jetuar normalisht, apo se të ardhurat e familjes janë të mjaftueshme për të mbijetuar, apo se të ardhurat e familjes janë vetëm ndihma sociale. Rreth 15% mendojnë se të ardhurat e tyre familjare nuk mjaftojnë as për ushqim. Shumë më pak nga gratë e anketuara deklarojnë se të ardhurat e familjes janë të mjaftueshme për të jetuar shumë mirë (8%) apo se të ardhurat e familjes mundësojnë jetë shumë të mirë dhe kursime (2%). Konsiderueshëm më shumë gra të anketuara rome deklarojnë se të ardhurat janë vetëm ndihma sociale (41%), krahasuar me ato ashkallike (23%) dhe egjiptiane (19%). Nga ana tjetër, më shumë gra egjiptiane (28%) dhe ashkallike (27%) sesa rome (12%) deklarojnë se të ardhurat e familjes janë të mjaftueshme për të jetuar normalisht. Ndërsa sa i përket rasteve me gjendje ekonomike më të mirë, vetëm një numër i vogël grash ashkallike (4%) deklarojnë se të ardhurat e familjes mundësojnë jetë shumë të mirë dhe kursime.

Figura 31 Gjendja ekonomike e familjeve të grave të anketuara




Përveç mbi gjendjen e tyre ekonomike familjare, gratë rome, ashkalice dhe egjiptiane po ashtu u pyetën se sa të brengosura janë për mirëqenien e tyre. Në total, 37% e grave të anketuara janë mesatarisht të brengosura, 30% janë shumë të brengosura, 24% janë pak të brengosura dhe 8% nuk janë aspak të brengosura për mirëqenien e tyre. Më shumë gra me gjendje ekonomike më të rëndë, sikurse ato që kanë vetëm ndihma sociale (48%) si dhe ato që nuk kanë mjaftueshëm as për ushqim (43%) janë shumë të brengosura për mirëqenien e tyre.

Figura 32 Brenga për mirëqenien e tyre, sipas nivelit të të ardhurave




Po ashtu, nëse krahasojmë Prishtinën si rajonin me më shumë banorë dhe me më mundësi me rajonet e tjera, shohim se gratë e anketuara që jetojnë në rajonet e tjera (37%) janë konsiderueshëm më shumë të brengosura për mirëqenien e tyre sesa ato që jetojnë në rajonin e Prishtinës (13%).

Figura 33 Brenga për mirëqenien e tyre, sipas rajonit



Duke qenë se qasja institucionale është qenësore në luftimin e pabarazive shoqërore dhe ekonomike, ky hulumtim i ka matur edhe ndjesitë e të anketuarave karshi obligimeve institucionale në përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike. Shumica e të anketuarave (74%) mendojnë se mbështetja financiare nga institucionet shtetërore kërkon angazhim urgjent. Pastaj, pas kësaj vinë punësimi në industri (47%), punësimi në shërbime ose tregti (37%), largimi jashtë vendit për të punuar (28%), punësimi në bujqësi (25%), dhe arsimimi i mëtejshëm (21%). Më pak përmendin mbështetjen financiare nga institucionet ndërkombëtare (9%), mbështetjen financiare nga të afërmit jashtë vendit (7%), apo largimin jashtë vendit për të studiuar (7%). Gratë e anketuara më të reja, pra 18-30 vjeç theksojnë më shumë adresimin e arsimit të mëtejshëm (34%) dhe largimit jashtë vendit për të studiuar (14%) krahasuar me dy grupmoshat e tjera.


Figura 34 Angazhim urgjent institucional për çështje të ndryshme



GJENDJA EKONOMIKE E GRAVE ROME, ASHKALIKE DHE EGJIPTIANE PËRGJATË PANDEMISË


Një nga dimensionet kryesore të cilat ky hulumtim ka synuar t'i vë në pah ka qenë ndikimi i pandemisë Covid-19 në mirëqenien ekonomike të grave rome, ashkalike dhe egjiptiane, përqësimit eventual të pozitës së tyre dhe rritjen e dhunës. Është evidentuar tashmë që pandemia Covid-19 ka pasur ndikim negativ në respektimin e të drejtave të njeriut, duke ua përqësuar gjendjen ekonomike dhe psikologjike të tyre. Kjo ka qenë edhe më e dukshme për grupet e paprivileguara shoqërore, të cilat janë ndeshur me diskriminim të shumëfishtë. Në këtë linjë, duke qenë që ende nuk ka të dhëna të sakta mbi implikimet e Covid-19 në jetën e grupeve të ndryshme shoqërore, ky hulumtim ka synuar që t'i vlerësojë ndjesitë dhe përvojat e grave rome, ashkalike dhe egjiptiane përgjatë pandemisë. Kur u pyetën nëse gjendja ekonomike u përqësua që nga shpërthimi i COVID-19 në Kosovë, 45% vlerësojnë se është përqësuar shumë, 44% se është përqësuar, 6% se është përqësuar mesatarisht dhe 5% se është përqësuar pak.

Figura 35 Përqësimi i gjendjes ekonomike pas përhapjes së COVID-19



Burimi kryesor për informacionin në lidhje me COVID-19, pra rrezikun, parandalimin, rekomandimet, masat e qeverisë dhe veprimet kundrejt tij janë radio, gazetat dhe televizionet (73%), ndërsa për 22% janë interneti dhe mediat sociale e për 3% komuniteti, përfshirë familjen dhe miqtë. Kurse, kur krahasojmë të dhënat sipas grupmoshës, gratë e anketuara më të reja, 18-30 vjeç, përdorin më shumë internetin e mediat sociale (43%), sesa ato të grupmoshave më të vjetra (21% - 31-44 vjeç dhe 4% - mbi 44 vjeç).


Figura 36 Kanalet e informimit rreth COVID-19, sipas grupmoshës



Ndërsa, kur analizojmë të dhënat sipas statusit të punësimit, gratë e anketuara të punësuar përdorin më shumë internetin dhe mediat sociale (52%) sesa ato të papunësuarat (20%) për t'u informuar rreth COVID-19. Gratë e punësuar përdorin konsiderueshëm më shumë edhe komunitetin (14%) për këtë


temë. E gratë e papunësuar përdorin shumë më shumë radio, gazetat dhe televizionin (77%) sesa ato të punësuarat (29%) si burim informacioni rreth COVID-19.

Figura 37 Kanalet e informimit rreth COVID-19, sipas statusit të punësimit




Më pas, të anketuarat u pyetën nëse kishin përjetuar formë të rritjes së diskriminimit ose paragjykitimit në vendin ku jetojnë pas përhapjes së COVID-19, ku 22% e tyre deklarojnë se kanë ndjerë rritje të diskriminimit. Më shumë nga grupmosha 18-30 vjeç (23%) se nga grupmosha 31-44 vjeç (22%), apo mbi 44 vjeç (20%) e ka ndjerë rritjen e diskriminimit ose paragjykitimit.

Figura 19 Ndjesia e rritjes së paragjykitimeve apo diskriminimit etnik që nga përhapja e COVID-19, sipas grupmoshës




Për më tepër, më shumë të anketuara nga rajonet e tjera të Kosovës (23%) sesa ato nga rajoni i Prishtinës (17%) kanë ndjerë rritje të diskriminimit apo paragjykitimit.

Figura 39 Ndjesia e rritjes së paragjykitimeve apo diskriminimit etnik që nga përhapja e COVID-19, sipas rajonit



Ndërsa, më shumë gra egjiptiane (40%) dhe rome (38%) kanë ndjerë rritje të diskriminimit ose paragjykitimit kur krahasojmë me gratë ashkalice (11%).

Figura 40 Ndjesia e rritjes së paragjykitimeve apo diskriminimit etnik që nga përhapja e COVID-19, sipas përkatësia etnike



Temë tjetër e shtjelluar përmes kësaj ankete ishte dhuna në familja. Të anketuarat u pyetën nëse kishin dëgjuar për rritjen e dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19. Më shumë se gjysma e të gjitha të anketuarave pohojnë një gjë të tillë (53%). Më shumë gra të grupmoshës 18-30 vjeç (62%) dhe që jetojnë në rajonin e Prishtinës (61%) pohojnë se kanë dëgjuar për rritjen e dhunës në familje.

Figura 41 Përshtypja mbi rritjen e dhunës në familje pas përhapjes COVID-19, sipas grupmoshës






Figura 42 Përshtypja mbi rritjen e dhunës në familje pas përhapjes COVID-19, sipas rajonit




E sipas përkatësisë etnike, mjaft më shumë gra egjiptiane (72%) sesa rome (50%) e ashkalice (46%) pohojnë se kanë dëgjuar për rritjen e dhunës në familje nga përhapja e COVID-19.



Për shkak të situatës së krijuar pas përhapjes së COVID-19 në periudha të ndryshme që nga marsi 2020 ku qytetarët kishin lëvizje të kufizuar e qasje të kufizuar në shërbime, të anketuarat po ashtu u pyetën për vështirësitë që mund t'i kenë hasur në qasjen në shërbime të shëndetit riprodhues. Më shumë se

gjysma e grave të anketuara (51%) nuk kishin pasur nevojë për shërbime të kujdesit gjinekologjik dhe obstetrik. Por, 43% kishin kërkuar këto shërbime, mirëpo nuk ishin përballur me ndonjë vështirësi, ndërsa vetëm 1% deklarojnë se ishin përballur me vështirësi. Nga ana tjetër, më shumë se dy të tretat e të anketuarave (64%) nuk kishin pasur nevojë për kontraceptivë, 18% kishin pasur, por nuk janë përballur me vështirësi, ndërsa edhe në këtë rast vetëm 1% deklarojnë se ishin përballur me vështirësi.

Figura 43 Qasja në shërbime të shëndetit riprodhues pas përhapjes së COVID-19



Të anketuarat që kanë deklaruar se tani janë të papunësuar, të punësuar kohë pas kohe, merren me grumbullim të materialeve ricikluese, bëjnë punë sezonale, bujqësore, apo tjetër, u pyetën nëse kishin qenë të punësuar para COVID-19 dhe vetëm 12% e tyre deklarojnë se kanë qenë të punësuar para COVID-19. Arsyet për humbjen e punës, apo sipas tyre, lënien e punës kishin të bëjnë me shëndet për tri prej tyre, me kushtet e punës për katër prej tyre, dhe me angazhimet familjare për dy prej tyre. Ndërsa, pesë prej tyre deklaruan se kishin humbur punën për shkak të pandemisë.

Figura 44 Punësimi para COVID-19 i grave të papunësuar ose me punësim jo-stabil





Figura 45 Arsyet për humbjen e punës pas përhapjes së COVID-19



Lidhur me ndikimin e COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike, 58% e grave deklaruan se mirëqenia ekonomike e tyre është më keq se para COVID-19, 38% se është njëjtë dhe 4% se është më mirë. Më shumë gra të moshës 31-44 vjeç (69%) dhe të atyre që jetojnë në rajonin e Prishtinës (65%) deklarojnë se mirëqenia ekonomike e tyre është më keq krahasuar me periudhën para COVID-19.

Figura 46 Mirëqenia ekonomike pas përhapjes së COVID-19, sipas grupmoshës






Figura 47 Mirëqenia ekonomike pas përhapjes së COVID-19, sipas rajonit



Konsiderueshëm më shumë gra romë (74%) se ashklike (58%), apo egjiptiane (50%) deklarojnë se mirëqenia ekonomike e tyre është më keq krahasuar me periudhën para COVID-19.

Figura 48 Mirëqenia ekonomike pas përhapjes së COVID-19, sipas përkatësisë etnike



Të anketuarat pastaj u pyetën nëse kanë përfituar ndonjë ndihmë institucionale ose nga OJQ-të në kuadër të ndihmave të ofruara për ta përballuar periudhën e pandemisë me COVID-19. Afro dy të tretat e të anketuarave (62%) deklaruan se kanë marrë ndihma prej entiteteve të ndryshme. Prej tyre, 53% kanë marrë ndihma nga shoqatat humanitare, 39% nga komunat, 34% nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, 12% nga iniciativa qytetare/lagjja/komuniteti, 10% nga diaspora, 3% nga qendra sociale dhe 1% nga partia politike.

Figura 49 Ndhimja të pranuar që nga përhapja e COVID-19





Figura 50 Ndhimat e pranuar që nga përhapja e COVID-19, sipas dhuruesve



PERCEPTIMET E GRAVE ROME, ASHKALIKE DHE EGJIPTIANE MBI NDARJEN E PUNËVE

Normat shoqërore mbi raportin gjini-punë mbesin në fundament të praktikave diskriminuuese shoqërore dhe institucionale të cilat përveç që krijojnë pabarazi në tregun e punës, ndikojnë edhe në “zgjedhjet” që gratë e burrat i ndërmarrin. Në Kosovë, tregu i punës mbetet thellësisht i gjinizuar, me një numër të ulët të grave të cilat absorbohen në treg. Për më tepër, tregu i punës- së paku ai formal, mbetet gjithashtu në shkallë të lartë i racializuar. Duke qenë se kjo është praktikë e normëzuar, ky hulumtim ka rreshtuar disa pohime rreth dinamikës së burrave dhe grave brenda familjes në lidhje me punët e shtëpisë, punën jashtë shtëpisë dhe marrëdhënieve burrë-grua e nënë-fëmijë, për çka të anketuarat duhet të tregonin pajtueshmëri ose mos-pajtueshmëri. Qëllimi i këtyre pohimeve ka qenë të evidentohet nëse ekziston një ndërlidhshmëri mes normave shoqërore, mënyrës se si ndahet puna brenda dhe jashtë shtëpisë mes gjinive dhe “zgjedhjeve të tyre”.

Shumica e të anketuarave (91%) pajtohen se edhe burri edhe gruaja duhet të kontribuojnë në të ardhurat e shtëpisë (51% pajtohen plotësisht e 40% pajtohen). Po ashtu, 81% pajtohen se të kesh një punë është mënyra më e mirë për një grua që të jetë e pavarur (48% pajtohen plotësisht, 33% pajtohen)

Megjithatë, pak më shumë se gjysma (51%) pajtohen se një fëmijë parashkollor ka gjasë të vuajë nëse nëna e vet punon (7% pajtohen plotësisht, 42% pajtohen). Ngjashëm, pothuajse gjysma (49%) pajtohen se në përgjithësi, jeta e familjes pëson kur gruaja punon me orar të plotë (7% pajtohen plotësisht, 42% pajtohen).

Po ashtu, pothuajse gjysma e grave të anketuara (48%) pajtohen se burrat duhet të bëjnë më shumë punë të shtëpisë sesa që bëjnë tani (12% pajtohen plotësisht, 36% pajtohen). Kurse, rreth 32% e grave të anketuara pajtohen se një nënë që është në punë mund të vendosë relacione po aq të ngrohta e të sigurta me fëmijët e saj si një nënë që nuk punon (4% pajtohen plotësisht, 28% pajtohen).


Vetëm rreth 31% e grave të anketuara besojnë se të jesh amvise është po aq e vlerësuar sa edhe puna me pagesë (9% pajtohen plotësisht, 22% pajtohen). Në këtë rast, më shumë gra (60%) nuk pajtohen me këtë konstatim (40% nuk pajtohen aspak, 20% nuk pajtohen).

Tutje, vetëm 22% e grave pajtohen se burrat tashmë bëjnë po aq punë shtëpie sa ua lejon koha (1% pajtohen plotësisht, 21% pajtohen). Por, edhe në këtë rast, 44% nuk pajtohen me këtë konstatim (24% nuk pajtohen aspak, 20% pajtohen).

Për më tepër, 21% e grave pajtohen me fjalinë se puna është e mirë, por ajo që gratë dëshirojnë është shtëpia dhe fëmijët. Por, 61% e grave të anketuara nuk pajtohen me këtë fjali (26% nuk pajtohen aspak, 35% nuk pajtohen).

Ndërsa, 20% e grave pajtohen se puna e burrit është të bëjë para; puna e gruas është që të kujdeset për shtëpinë dhe familjen (4% pajtohen plotësisht, 16% pajtohen). Por, më shumë se gjysma e grave (59%) nuk pajtohen me këtë (30% nuk pajtohen aspak, 29% nuk pajtohen).


Figura 51 Niveli i pajtimit me pohime të ndryshme rreth dinamikës gjinore në familje



Matur në një shkallë nga 1.0 deri në 5.0 pikë, ku 1 do të thotë "nuk pajtohem aspak" dhe 5 do të thotë "pajtohem plotësisht, vërehet se gratë e grupmoshës mbi 44 vjeç kanë shkallë më të vogël të pajtimit (2.58) sesa ato 18-30 vjeç (2.83) dhe 31-44 vjeç (2.86) me faktin që një nënë që është në punë mund të vendosë relacione po aq të ngrohta e të sigurta me fëmijët e saj si një nënë që nuk punon.

Çuditërisht, po të njejtat të anketuara (mbi 44 vjeç) pajtohen më pak (2.04) sesa ato 18-30 vjeç (2.43) e 31-44 vjeç (2.52) se puna e burrit është të bëjë para e puna e gruas është që të kujdeset për shtëpinë dhe familjen.

Figura 52 Niveli i pajtimit me pohime të ndryshme rreth dinamikës gjinore në familje, sipas grupmoshës




Përveç disa dallimeve sipas moshës, vërehen edhe dallime sipas nivelit të shkollimit. Për shembull, shumë më shumë gra me shkollim të mesëm ose më të lartë pajtohen (4.03) se burrat duhet të bëjnë më shumë punë të shtëpisë sesa që bëjnë tani kur krahasojmë me gratë që kanë filluar apo përfunduar shkollën fillore (3.21) dhe ato që nuk kanë shkollë fare (3.21).

Edhe për një tjetër pohim ka dallim të konsiderueshëm në pajtim sipas nivelit të shkollimit. Shumë më pak gra me shkollim të mesëm ose më të lartë (2.40) pajtohen se jeta e familjes pëson kur gruaja punon me orar të plotë kur krahasojmë me ato me shkollë fillore (3.15) dhe pa shkollë (3.15).


Gratë më të shkolluara po ashtu pajtohen shumë më pak se puna është e mirë, por ajo që gratë vërtet dëshirojnë është shtëpia dhe fëmijët (2.0) dhe se puna e burrit është të bëjë para e puna e gruas është që të kujdeset për shtëpinë dhe familjen (1.96) sesa gratë me shkollë fillore (2.43 dhe 2.41, përkatësisht) dhe ato pa shkollë fare (2.42 dhe 2.35, përkatësisht).

Figura 53 Niveli i pajtimit me pohime të ndryshme rreth dinamikës gjinore në familje, sipas nivelit të shkollimit



Në nivelin e pajtimit për këto pohime vërehen edhe dallime sipas përkatësisë etnike. Për shembull, më pak gra të anketuara egjiptiane pajtohen se një fëmijë parashkollor ka gjasa të vuajë nëse nëna e vet punon (2.66) dhe se jeta e familjes pëson kur gruaja punon me orar të plotë (2.26) sesa gratë rome (3.19 dhe 3.06, përkatësisht) dhe gratë ashkalike (3.30 dhe 3.34 përkatësisht). Ndërsa, për faktin se të jesh amvisë është po aq e vlerësuar sa edhe puna me pagesë, më shumë gra ashkalike (2.60) pajtohen se sa rome (2.06) dhe egjiptiane (1.98).

Figura 54 Niveli i pajtimit me pohime të ndryshme rreth dinamikës gjinore në familje, sipas përkatësisë etnike



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky raport analizoi dhe interpretoi rezultatet e anketës me 250 gra rome, ashkalike dhe egjiptiane për të kuptuar gjendjen ekonomike të tyre duke hulumtuar nivelin e tyre të arsimimit, mundësitë dhe sfidat në punësim si dhe mirëqenien ekonomike, sociale dhe shëndetësore.

Analiza është bërë në nivel të përgjithshëm për të gjitha gratë e me raste janë parë diferencat sipas moshës, statusit të punësimit, përkatësisë etnike si dhe rajonit. Duhet theksuar se në nivel të përgjithshëm, rezultatet janë përfaqësuese për të tri komunitetet në fjalë, mirëpo në raste të tjera, kur numri i përgjigjeve ishte shumë i vogël bazuar në karakteristikat e të anketuarave, rezultatet janë vetëm indikative.

ARSIMI DHE PUNËSIMI

Niveli i përgjithshëm i arsimit të grave rome, ashkalike dhe egjiptiane në Kosovë është i ulët. Në të vërtetë, më shumë se gjysma e të anketuarave (54%) kanë filluar apo përfunduar vetëm shkollën fillore dhe një në tre gra të anketuara (33%) nuk kanë shkollim fare. Vetëm pak më shumë se një në 10 gra (13%) kanë përfunduar shkollën e mesme apo kanë vijuar edhe shkollim më të lartë gjë që lë të nënkuptohet se qasja në arsim të lartë është mjaft e kufizuar për gratë e këtyre tri komuniteteve.

Përveç kësaj, ka gra që kanë deklaruar se nuk e kanë përfunduar shkollën fillore apo të mesme dhe kriesisht e kanë lënë shkollën për shkak të kushteve ekonomike (38%), por po ashtu edhe për shkak të familjes (18%), ndër arsye të tjera sikurse koha e rrezikshme për shkollim, mos dëshira për vazhdim të shkollimit, angazhimet familjare, apo martesë.

Për më tepër, edhe llojet e kanaleve të informimit dallojnë sipas nivelit të shkollimit. Më shumë gra që kanë shkollë të mesme ose më të lartë (84%) përdorin rrjetet sociale sesa ato me shkollë fillore të filluar ose të përfunduar (36%) apo pa shkollë (14%) që mund të konsiderohet indikacion i problemit me shkrim dhe lexim dhe qasje të kufizuar në informata të shkruara qofshin ato për politikë, ekonomi, apo çështje aktuale.

Niveli i përgjithshëm i punësimit të grave rome, ashkallike dhe egjiptiane në Kosovë është edhe më i ulët. Në të vërtetë, vetëm 8% e grave (nga 250 të anketuara) janë të punësuara, qoftë edhe të vetëpunësuara apo pjesërisht të punësuara. Nga pjesa e papunësuar e grave, më shumë janë amvise, apo nuk kërkojnë punë dhe një numër më i vogël i tyre janë studente apo pensioniste. Vetëm 12 prej grave të punësuara (që punojnë për dikë tjetër dhe jo për veten) kanë kontratë të rregullt pune e gjashtë nuk kanë. Po ashtu 17 prej tyre punojnë me orar të plotë e katër me orar të shkurtuar. E vetëm 13 prej tyre marrin pagën përmes bankës e pesë prej tyre paguhen në kesh. Të gjitha gratë e anketuara kanë treguar sfidat me të cilat janë ballafaquar në punësim përgjatë jetës së tyre, e më shumë se një në tre prej tyre (35%) janë shprehur se kanë pasur vështirësi të përmbushin kriteret e kërkuara për vendin e punës dhe pothuajse një në pesë prej tyre (18%) kanë përmendur si sfidë gjetjen e një pune që i përshtat kualifikimeve të tyre (18%).

Megjithëse në Kushtetutën e Kosovës dhe një numër ligjesh sigurohen të drejtat e barabarta të komuniteteve pakicë në Kosovë dhe ka mekanizma shtytës për t'u kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të marginalizuara, nëse bazohemi tek këto të dhëna shihet se në aspektin e arsimit dhe punësimit ka hapësirë të madhe për përmirësimin e qasjes së grave rome, ashkallike dhe egjiptiane në arsim dhe punësim.

Si rrjedhojë në këto aspekte institucionet shtetërore, organizatat jo-qeveritare dhe ato ndërkombëtare duhet të bashkëpunojnë dhe t'i kushtojnë rëndësi të veçantë:

- ▶ Krijimit të mekanizmave dhe programeve speciale për të rritur numrin e vajzave dhe grave rome, ashkallike dhe egjiptiane në arsim të lartë, qoftë në arsim të përgjithshëm/akademik apo profesional
- ▶ Ndërtimit të shkollave fillore dhe të mesme në afërsi të vendeve ku jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë për t'ua lehtësuar qasjen në to
- ▶ Kur është e mundur, nxitjes së pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve në shkolla të përbashkëta në një gjuhë zyrtare që të gjitha komunitetet shumicë dhe pakicë e kuptojnë
- ▶ Krijimit të mekanizmave mbikëqyrëse për të parë nëse programet po zbatohen si duhet
- ▶ Ofrimit të stimulimit financiar që të rritet cilësia dhe numri i mësimdhënësve në vende jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë
- ▶ Krijimit të trajnimeve të vazhdueshme edhe të mësimdhënësve për të rritur kapacitetet e tyre dhe për t'i përshtatur ato me kërkesat e tashme të tregut
- ▶ Krijimit të mekanizmave moderne për matjen e nivelit të mësim nxënies në nivel fillor dhe të mesëm
- ▶ Krijimit të programeve të dyfishta për arsim dhe punësim përmes aftësisimit profesional të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë e sidomos të vajzave dhe grave të këtyre komuniteteve

MIRËQENIA EKONOMIKE, SOCIALE DHE SHËNDETËSORE

Gjendja ekonomike familjare e grave të anketuara rome, ashkallike dhe egjiptiane në përgjithësi nuk është adekuate. Nga një e katërta (25%) deklarojnë se të ardhurat familjare janë vetëm sa për të mbijetuar apo se janë vetëm ndihma sociale e 15% deklarojnë se nuk mjaftojnë as për ushqim. Një pjesë tjetër e grave (25%) deklarojnë se të ardhurat ju mjaftojnë të jetojnë normalisht e më pak se një në 10 gra (8%) deklarojnë se kanë të ardhura për të jetuar shumë mirë, ndërsa vetëm 2% thonë se të ardhurat u mundësojnë të jetojnë shumë mirë dhe të kenë edhe kursime. Sa i përket brengosjes mbi mirëqenien e tyre, vetëm 8% e grave nuk janë aspak të brengosura për mirëqenien e tyre ndërsa të tjerat janë pak (24%), mesatarisht (37%), apo shumë të brengosura (30%).

Si pasojë e një gjendjeje të tillë ekonomike dhe brengave për mirëqenien e tyre si rrjedhojë, shumica dërrmuese e të anketuarave (74%) kërkojnë angazhim urgjent të institucioneve shtetërore për

mbështetje financiare ndaj tyre; e pastaj në pjesë më të vogla kërkojnë angazhim të këtyre institucioneve edhe për t'i punësuar në sektorë e industri të ndryshme apo për arsimimin të mëtejshëm. Gratë e anketuara më të reja kërkonin angazhim më urgjent për adresimin e arsimimit të mëtejshëm (34%) dhe largimit jashtë vendit për të studiuar (14%).

Për sa i përket ndikimit të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike, më shumë se gjysma e grave ë anketuara (58%) kanë deklaruar se mirëqenia ekonomike e tyre është përkeqësuar pas përhapjes së COVID-19. Më shumë gra që jetojnë në rajonin e Prishtinës (65%) deklarojnë një gjë të tillë. Për më tepër, konsiderueshëm më shumë gra romë (74%) se ashklike (58%), apo egjiptiane (50%) deklarojnë se mirëqenia ekonomike e tyre është më keq krahasuar me periudhën para COVID-19. Sa i përket qasjes në shërbime të shëndetit riprodhues, gjysma e grave të anketuara nuk kishin pasur nevojë për ato shërbime, por në rastet kur kishin pasur nevojë, kryesisht nuk ishin përballur me vështirësi në qasje.

Sa i përket mirëqenies sociale apo pozitës së grave brenda familjes dhe në raport me burrat, shumica dërrmuese e të anketuarave pajtohen se edhe burri edhe gruaja duhet të kontribuojnë në të ardhurat e shtëpisë. Po ashtu, një pjesë e madhe e tyre (81%) pajtohen se të kesh një punë është mënyra më e mirë për një grua që të jetë e pavarur.

Mirëpo, megjithëse shumica mendojnë se puna siguron pavarësi ekonomike për gratë, mbi gjysma e tyre po ashtu pajtohen se një fëmijë parashkollor ka gjasë të vuajë nëse nëna e vet punon. Për më tepër, pothuajse gjysma (49%) pajtohen se në përgjithësi, jeta e familjes pëson kur gruaja punon me orar të plotë. Kurse, vetëm një në tri gra (32%) e grave të anketuara pajtohen se një nënë që është në punë mund të vendosë relacione po aq të ngrohta e të sigurta me fëmijët e saj si një nënë që nuk punon

Në kontradiktë me mendimin e pavarësisë ekonomike të grave përmes punësimit, rreth një në pesë (20%) gra pajtohen se puna e burrit është të bëjë para dhe se puna e gruas është që të kujdeset për shtëpinë dhe familjen duke lënë të nënkuptohet një paragjykim ndaj grave që punojnë.

Andaj, sa i përket këtyre çështjeve, institucionet shtetërore, organizatat jo-qeveritare dhe ato ndërkombëtare duhet të bashkëpunojnë dhe t'i kushtojnë rëndësi të veçantë:

- ▶ Ofrimit të ndihmave sociale për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë duke u trajtuar secili komunitet veç e veç
- ▶ Ofrimit të ndihmave financiare shtesë për të lehtësuar ndikimin e COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë e sidomos të grave të këtyre komuniteteve
- ▶ Ofrimit të kampanjave vetëdijesuese mbi çështjet gjinore, veçanërisht barazinë gjinore, ndryshimin e kuptimit të roleve të ndara gjinore brenda familjes dhe rolit të prindërve qoftë baba apo nënë. Kjo duhet synuar sidomos tek gratë romë, ashklike dhe egjiptiane që kanë më pak vite shkollim.

REFERENCA

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Popullsia sipas përkatësisë etnike/kulturore, gjinisë dhe komunës 2011.

<https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata_Census%20population_Census%202011_3%20By%20Municipalities/tab%205%204.px/table/tableVieëLayout1/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/>

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Anketa e fuqisë punëtore 2020. <<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-neës/anketa-e-fuqise-punetore-afp-2020>>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve. <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-032 për arsimin para-universitar. <<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore. <<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2533>>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë ,13 mars 2008. <<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>>

